



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL ASSEMBLY-SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika (d) të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisje lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”, e në mbështetje të nenit, 28, paragrafi 2, pika (b), 29, paragrafi 2, pika (c) dhe 56, te Statutit të Komunës në Suharekë, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës së Suharekës, në mbledhjen e mbajtur më datën, 27.02.2019, miraton këtë;

V E N D I M

Neni 1

Me këtë vendim Gratë-Nënat që lindin fëmijë në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Suharekë, për çdo lindje të fëmijës do të subvencionohet me nga **250€** mjete financiare.

Neni 2

2.1 Ky subvencionim do të fillon të bëhet nga data 01.01.2019, për të gjitha ato gra-nënë që lindin pas kësaj date të cekur më lartë.

2.2 Subvencionimi bëhet nga mjetet vetanake të Komunës së Suharekës nga kategoria e subvencioneve të Drejtorisë për shëndetësi dhe mirëqeni sociale.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, përkatësisht Drejtoria për shëndetësi dhe mirëqenie sociale në Suharekë.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, nenit 8, të Rregullores (QRK), Nr-01/2016, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

K U V E N D I I K O M U N S Ë N Ë S U H A R E K Ë

01-Nr-016-14934
Me datë 28.02.2019

